SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve të Aplikuara**
Programi:	**Dizajni Grafik dhe Multimedia**
Titulli i lëndës:	**Ndërmarrësia**
Niveli:	**Baçelor**
Statusi i lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**II**
Semestri:	**III**
Numri orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**4**
Koha / lokacioni:	**USHAF**
Përshkrimi i lëndës	Lënda Ndërmarrësia trajton në mënyrë të integruar procesin ndërmarrës, nga identifikimi dhe vlerësimi i ideve e mundësive të biznesit deri te krijimi, zhvillimi dhe rritja e ndërmarrjes. Përmbajtja përfshin mendësinë ndërmarrëse, kreativitetin dhe inovacionin, analizën e tregut dhe konsumatorit, fizibilitetin, modelin e biznesit, validimin e idesë, planifikimin financiar, financimin, organizimin, marketingun dhe menaxhimin e rritjes. Gjithashtu trajtohen transformimi digjital, inteligjenca artificiale, ndërkombëtarizimi, qëndrueshmëria dhe menaxhimi i rrezikut. Përmes qasjes teorike dhe praktike, studentët zhvillojnë aftësi për analizë, vendimmarrje dhe zbatim të njohurive në situata konkrete ndërmarrëse.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i lëndës **Ndërmarrësia** është t'u ofrojë studentëve një kuptim të strukturuar të procesit ndërmarrës dhe t'i aftësojë për identifikimin, vlerësimin dhe zhvillimin e ideve dhe mundësive të biznesit. Lënda synon të zhvillojë mendësinë ndërmarrëse, aftësinë analitike dhe vendimmarrjen, duke integruar analizën e tregut, fizibilitetin, modelin dhe planin e biznesit, financimin, organizimin, marketingun dhe rritjen. Njëkohësisht, studentët aftësohen të vlerësojnë ndikimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimit, qëndrueshmërisë dhe rrezikut në zhvillimin e ndërmarrjeve dhe t'i zbatojnë njohuritë në situata praktike.
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit me sukses të lëndës **Ndërmarrësia**, studenti do të jetë në gjendje të: 1. **Shpjegojë** konceptet, teoritë dhe proceset kryesore të ndërmarrësisë, si dhe rolin e ndërmarrësit dhe të ekosistemit ndërmarrës në zhvillimin e biznesit. **(ECTS: 1),** 2. **Identifikojë dhe vlerësojë** ide dhe mundësi biznesi përmes kreativitetit, analizës së tregut, konsumatorit, konkurrencës dhe fizibilitetit. **(ECTS: 1),** 3. **Ndërtojë dhe testojë** modelin e biznesit dhe propozimin e vlerës, duke përdorur qasje të validimit,

	mendimit dizajnues dhe produktit minimal të realizueshëm. **(ECTS: 1),** 4. **Hartojë dhe analizojë** elementet kryesore të planit të biznesit, përfshirë financimin, organizimin, marketingun, shitjen dhe planifikimin financiar. **(ECTS: 1),** 5. **Vlerësojë dhe zbatojë** njohuritë ndërmarrëse në situata praktike, duke analizuar ndikimin e teknologjisë, ndërkombëtarizimit, qëndrueshmërisë dhe rrezikut në zhvillimin dhe vazhdimësinë e biznesit. **(ECTS: 1),**

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	5	5
Përgatitja për detyra projekte			
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare në provim	1	7	7
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	1	1
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			**100**

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Mësimdhënia do të zhvillohet me qasje të orientuar te studenti, duke ndërthurur ligjëratat teorike me zbatimin praktik të njohurive. Procesi mësimor do të realizohet përmes ligjëratave interaktive, diskutimeve, analizës së rasteve, ushtrimeve individuale dhe grupore, detyrave praktike dhe zhvillimit të planit të biznesit. Në trajtimin e temave do të përdoren shembuj konkretë, studime rasti dhe materiale bashkëkohore, me qëllim që studentët të lidhin konceptet teorike me situatat reale të ndërmarrësisë dhe menaxhimit të biznesit. Puna në grup, prezantimet dhe diskutimet do të përdoren për zhvillimin e mendimit kritik, aftësive analitike, komunikimit dhe vendimmarrjes. Mësimdhënia do të mbështetet gjithashtu në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale për prezantimin e përmbajtjes, kërkimin, bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve praktike.
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	**Metoda e vlerësimit** – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare: ➢ Aktivitet dhe Rasti i studimit.....**max 10 pikë (%),** ➢ Hartimi / prezantimi i Planit te Biznesit.....**max 20 pikë (%)**, ➢ Provimi final (ose nga dy teste).....**max 70 pikë (%),**

Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit:

1. **Aktiviteti në mësim dhe Rasti i studimit – vlerësohet me 10 pikë (%) nga 100 pikët (%)e mundshme:**
   - Aktiviteti në mësim **(5 pikë (%))** - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjatë ligjëratave.
   - Rasti i studimit **(5 pikë (%))** - nënkupton që studenti te realizon nje raste studimi ndërlidhur me ndërmarrësin dhe ta prezantoj te njëjtin para studenteve.
     Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - te ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulin e lendes.

2. **Hartimi dhe prezantimi i Planit te Biznesit - vlerësohet me 20 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,**
   Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 4 studentë) duhet të përgatit një Plan Biznesor (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim i planit duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta. Plani biznesor prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit te planit biznesor	
Komponenti	**Pikët (%)**
Struktura e planit biznesor	**4**
Përmbajtja/shtjellimi i planit	**9**
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi	**7**
Gjithsej:	**20**

   Qëllimi: zhvillimi i aftësive analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një plani reale biznesor - në mënyrë të pavarur dhe akademike - te ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulin e lëndës.

3. **Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,**
   Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose te 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejt ti nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me goje ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit.
   Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet te plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kritereve dhe përmban:

<table>
<tr><td></td><td>

pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri-kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....30 pikë (%),
pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....40 pikë (%)

Qëllimi i testit: është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies te parapara në modulin e lëndës dhe për t’i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:
<table>
<tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr>
<tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr>
<tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr>
<tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr>
<tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr>
<tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr>
<tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Mjetet e konkretizimit – TI</td><td>Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.</td></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
<tr><td>Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit</td><td>80% - Teori,
20% - Ushtrime/detyra praktike,
Ky raport ka për qëllim të analizojë lidhjen ndërmjet njohurive teorike të përfituara gjatë ligjëratave të parapara në modulin e lëndës dhe realizimit të ushtrimeve praktike (vizita praktike, ushtrime me studentë, kuize studentore në klase, etj).
Nga gjithsej 125 orë të parapara për lëndën, ndarja është bërë sipas raportit 80% me fokus në teori dhe 20% në ushtrime/detyra praktike.

100 orë janë të dedikuara për ligjërata teorike, përfshirë përvetësimin e koncepteve bazë, metodologjive dhe standardeve të parapara ne modulin e lëndës.
25 orë janë të fokusuara në ushtrime/detyra praktike, analiza rastesh konkrete, punë në grup dhe zhvillim projektesh simulimi.

Ndarja e 6 ECTS sipas raportit 80%-20%

4 ECTS - i dedikohen pjesës teorike,
1 ECTS - i dedikohen pjesës ushtrime/detyra praktike,

Kjo ndarje reflekton balancën ndërmjet përvetësimit të koncepteve bazë dhe zbatimit të tyre përmes aktiviteteve praktike.</td></tr>
<tr><td></td><td></td></tr>
</table>

Literatura	
Literatura bazë	1. Emeric Solymossy & Safet Merovci, "Ndërmarrësia", Prishtinë, 2008. 2. Arben Tërstena "Ndërmarrësia: Nga ideja te krijimi, zhvillimi dhe rritja e biznesit", 2026.
Literatura shtesë	1. Anastas Angjeli, Ermelinda Kordha & Alma Spaho, *"Ndërmarrësi"*, Tiranë, 2020. 2. Charles Bamford & Garry Bruton, *"Entrepreneurship: The Art, Science, and Process for Success"*, Fourth Edition, McGraw Hill, 2021.
Informacion shtesë **– Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:**	* Punimi Shkencor - nga autorët: Arben Tërstena, Ismail Mehmeti & Sokol Krasniqi: Titulli: "Analiza e perceptimeve të pronarëve dhe menaxherëve mbi faktorët që ndikojnë në efektivitetin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme: Evidenca nga Kosova" Butuar në: International Journal of Applied Economics, Finance and Accounting Vol. 17, No. 1, pp. 67-75, ISSN2577-767X Jun 2023 http://onlineacademicpress.com/index.php/IJAEFA/article/view/1036/765 https://www.scopus.com/authid/detail.uri?authorId=57961121300
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë	**Hyrje në ndërmarrësi, kuptimi dhe zhvillimi historik** Në këtë ligjëratë studentët do të njihen me strukturën e lëndës dhe konceptet themelore të ndërmarrësisë. Do të trajtohen zhvillimi historik, qasjet teorike, format e ndërmarrësisë dhe roli i saj në krijimin e vlerës dhe zhvillimin ekonomik. **Rezultati i pritur: RN1.**
Java e dytë	**Ndërmarrësi dhe mendësia ndërmarrëse** Në këtë ligjëratë do të trajtohen profili i ndërmarrësit modern, karakteristikat, motivimi, kompetencat, inteligjenca emocionale dhe rezilienca. Do të analizohen dallimet ndërmjet ndërmarrësit, menaxherit dhe të vetëpunësuarit. **Rezultati i pritur: RN1.**
Java e tretë	**Ekosistemi ndërmarrës dhe konteksti i Kosovës** Në këtë ligjëratë studentët do të analizojnë komponentët dhe aktorët e ekosistemit ndërmarrës, politikat publike, inkubatorët, akseleratorët dhe modelin Triple Helix. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mjedisit ndërmarrës dhe faktorëve që ndikojnë në efektivitetin e NVM-ve në Kosovë. **Rezultati i pritur: RN1.**
Java e katërt	**Kreativiteti, idetë dhe mundësitë ndërmarrëse** Në këtë ligjëratë do të trajtohen kreativiteti, inovacioni, burimet dhe teknikat e gjenerimit të ideve. Studentët do të aftësohen të dallojnë idenë

	nga mundësia ndërmarrëse dhe të vlerësojnë potencialin e saj në raport me tregun, mjedisin dhe konkurrencën. **Rezultati i pritur: RN2.**
Java e pestë	**Analiza e tregut dhe e konsumatorit** Në këtë ligjëratë studentët do të njihen me procesin e hulumtimit të tregut, mbledhjen e të dhënave, segmentimin, tregun e synuar dhe pozicionimin. Do të trajtohen profili i klientit, nevojat dhe sjellja e konsumatorit, si dhe analiza e konkurrencës. **Rezultati i pritur: RN2.**
Java e gjashtë	**Fizibiliteti dhe përzgjedhja e idesë** Në këtë ligjëratë do të trajtohet vlerësimi i fizibilitetit të tregut, teknik, operacional, organizativ, juridik, financiar dhe mjedisor. Studentët do të analizojnë burimet dhe skenarët kryesorë për të vlerësuar realizueshmërinë e një ideje biznesi. **Rezultati i pritur: RN2.**
Java e shtatë	**Modeli i biznesit dhe propozimi i vlerës** Në këtë ligjëratë studentët do të njihen me modelin e biznesit, Kanavacën e Modelit të Biznesit dhe Kanavacën e Propozimit të Vlerës. Do të trajtohen modelet e të ardhurave, testimi i supozimeve dhe pivotimi i modelit të biznesit. **Rezultati i pritur: RN3.**
Java e tetë	**Vlerësimi i dijes – Kollokviumi I** Në këtë javë do të realizohet vlerësimi i parë i njohurive të fituara në javët 1–7, me fokus në konceptet e ndërmarrësisë, ekosistemin, kreativitetin, analizën e tregut, fizibilitetin dhe modelin e biznesit. Parashihet të organizohet Testi i parë. **Rezultatet e pritshme: RN1, RN2 dhe RN3.**
Java e nëntë	**Mendimi dizajnues, MVP-ja dhe validimi** Në këtë ligjëratë do të trajtohen mendimi dizajnues, empatia, përcaktimi i problemit, prototipimi dhe testimi me përdoruesit. Studentët do të zbatojnë konceptin e MVP-së, ciklin ndërto–mat–mëso dhe metodat e validimit të supozimeve. **Rezultati i pritur: RN3.**
Java e dhjetë	**Marka dhe pronësia intelektuale** Në këtë ligjëratë studentët do të analizojnë identitetin, pozicionimin, reputacionin dhe kapitalin e markës. Do të trajtohen format kryesore të pronësisë intelektuale, mbrojtja e aseteve krijuese dhe përdorimi etik i inteligjencës artificiale. **Rezultatet e pritshme: RN3 dhe RN5.**
Java e njëmbëdhjetë	**Plani i biznesit dhe financat bazë** Në këtë ligjëratë do të trajtohen struktura dhe elementet kryesore të planit të biznesit, përmbledhja ekzekutive, vizioni, misioni, analiza e tregut dhe planet funksionale. Studentët do të njihen me kostot, çmimin, të ardhurat, fitimin, pikën e barazimit, fluksin e parasë dhe treguesit financiarë. **Rezultati i pritur: RN4.**
Java e dymbëdhjetë	**Financimi, organizimi dhe lidershipi** Në këtë ligjëratë studentët do të analizojnë burimet dhe fazat e financimit, kreditë, grantet, investitorët dhe format alternative të kapitalit. Do të

	trajtohen gjithashtu forma juridike, struktura organizative, operacionet, lidershipi, ekipi dhe kultura organizative. **Rezultati i pritur: RN4.**
Java e trembëdhjetë	**Marketingu, shitja dhe rritja e biznesit** Në këtë ligjëratë do të trajtohen propozimi unik i shitjes, përzierja e marketingut, marketingu digjital, rrugëtimi i klientit, procesi i shitjes dhe negocimi. Studentët do të analizojnë mbajtjen e klientëve, përshtatjen produkt–treg dhe strategjitë e rritjes dhe shkallëzimit. **Rezultati i pritur: RN4.**
Java e katërmbëdhjetë	**Ndërmarrësia digjitale, ndërkombëtare dhe e qëndrueshme** Në këtë ligjëratë studentët do të analizojnë modelet digjitale të biznesit, tregtinë elektronike, inteligjencën artificiale dhe sigurinë digjitale. Do të trajtohen ndërkombëtarizimi, eksporti, diaspora, ndërmarrësia sociale dhe e gjelbër, ekonomia qarkore dhe ESG-ja. **Rezultati i pritur: RN5.**
Java e pesëmbëdhjetë	**Menaxhimi i rrezikut, krizave dhe vazhdimësia e biznesit – Kollokviumi II** Në këtë ligjëratë do të trajtohen identifikimi, klasifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve strategjike, financiare, operative, teknologjike, juridike dhe reputacionale, si dhe menaxhimi i krizave dhe vazhdimësia e biznesit. Në pjesën përmbyllëse do të realizohet Kollokviumi II. **Rezultati i pritur: RN5; Vlerësimi përfshin RN3–RN5**
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pështpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	